REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE

# EKONOMIA DHE BUXHETI

# 2014






***DHJETOR 2014***

# Raportí Mujor

Dhjetor, 2014

*Kontakt:*

*e-mail: marsed.harizi@financa.gov.al*

*e-mail: eva.doda@financa.gov.al*

(website - www.financa.gov.al)

# PËRMBAJTJA

VEÇORITË KRYESORE.....2

ZHVILLIMET EKONOMIKE.....3

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit 3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave 5
4. Bilanci i Pagesave 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar 7
6. Kredia për Ekonominë 8
7. Oferta e Parasë 9
8. Depozitat sipas Burimeve 10

SEKTORI FISKAL.....11

1. Buxheti i Konsoliduar 11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve 12

ANEKSI STATISTIKOR.....13

# VEÇORITË KRYESORE

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin dhjetor 2014 arriti në 116.98 për qind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin dhjetor ishte 0.7 për qind;
- *Kursi mesatar i këmbimit* të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin dhjetor 2014 ishte 113.64 lekë për dollarë dhe 140.11 lekë për euro;
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit dhjetor shënuan kuotat 1.51 për ato 12 - mujore, 1.16 për 6 - mujoret ,0.83 për qind për depozitat 3 - mujore dhe 1.47 për depozitat 1 - mujore;
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 7.00 për qind për huatë 12 - mujore dhe 8.18 për ato 6 - mujore;
- *Oferta totale e parasë*, e matur nga agregati M3, arriti në 1,195.1 miliardë lekë në muajin nëntor, duke shënuar një rritje prej rreth 4.0 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i pagesave* për peridhën T3 2014 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej 89.75 milionë euro;
- Situata Buxhetore për periudhën janar - dhjetor 2014 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej rreth 72.1 miliardë lekë, ose 18.5 për qind më pak e planit për këtë muaj (e cila ishte 88.5 miliardë).
- Të ardhurat gjithsej të realizuara gjatë periudhës janar - dhjetor 2014, arritën në rreth 366.7 miliardë lekë, ose afërsisht 99.7 për qind e planit për muajin.
- Shpenzimet gjithsej gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 438.8 miliardë lekë, ose 96.1 për qind e shpenzimeve të planifikuara për këtë muaj.

# ZHVILLIMET EKONOMIKE

## 1.Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin dhjetor 2014 pësoi një rritje prej 0.7 për qind krahasuar me muajin nëntor ’14, kur ky indeks shënonte një rënie prej 0.2 për qind, krahasuar me muajin paraardhës. Ndërsa gjatë muajit tetor ’14, ky indeks ishte 0.1 për qind më i i lartë se në muajin shtator ’14. Ndryshimet respektive me të njëjtët muaj të një viti më parë ishin rritje 1.7 për qind, rënie me 0.5 për qind dhe rritje me 0.1 për qind. Rënia me e madhe mujore, gjatë muajit dhjetor u konstatua në grupin “Shëndeti” me 5.6 për qind. Pesha specifike relativisht e ulët që zë ky grup në shportën e mallrave të konsumit, bën që ndryshimet e çmimeve për këtë grup të kenë efekte të ulëta mbi normën e inflacionit (rreth 0.2 pikë përqindjeje). Ndërsa rritja më e madhe u konstatua në grupin “Shërbimi arsimor” me 11.2 për qind (duke kontribuar me 0.2 pikë përqindje në normën e inflacionit).

Fig-1




***Ndryshimet mujore të IÇK-së***

Burimi: INSTAT

Norma vjetore e inflacionit në muajin nëntor arriti në 0.7 për qind, duke qendruar poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë. Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, në përqindje, për vitet 2013 dhe 2014 paraqiten në tabelën 1.

Tab - 1 ***Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)***

| *VITI* | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor |
|---|---|---|---|---|---|---|
| ***2013*** | 2.7 | 2.5 | 2.4 | 2.3 | 2.1 | 2.3 |
| ***2014*** | 1.7 | 1.9 | 2.2 | 1.7 | 1.6 | 1.5 |
| *VITI* | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | **Nëntor** | Dhjetor |
| ***2013*** | 1.6 | 1.2 | 1.7 | 1.7 | 1.0 | 1.9 |
| ***2014*** | 1.8 | 2.0 | 1.5 | 1.4 | 1.7 | **0.7** |

*Burimi: INSTAT*

# 2.Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin dhjetor 2014, arriti në 140.11 lekë/euro, duke shënuar një rritje me 0.3 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit dhjetor, një euro u këmbye me 140.14 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin dhjetor 2014, arriti në 113.64 lekë/dollarë duke shënuar një rritje prej 1.5 për qind kundrejt muajit nëntor '14. Në fund të muajit dhjetor, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 115.23 lekë/dollarë.

Fig-2




*Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë muajit Dhjetor 2014*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në krahasim me muajin dhjetor të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është nënçmuar (mesatarisht) ndaj dollarit amerikan në masën 12.6 për qind, ndërsa kundrejt monedhës europiane euro është mbiçmuar me 0.05 për qind. Nënçmimi dhe mbiçmimi i lekut, kundrejt dy monedhave kryesore, monedhës europiane euro dhe monedhës amerikane, në radhë të parë është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar. Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan pësoi një rritje mesatare duke arritur në rreth 0.822 euro/dollarë.

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji, përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.

# 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit dhjetor 2014, normat e interesit të depozitave 12-mujore në lekë arritën kuotën e 1.51 për qind, duke shënuar një rënie me 0.06 pikë përqindje krahasuar me muajin nëntor 2014. Rënie për këtë muaj ka patur edhe në normat e interesit të depozitave me afate të maturimit 1-mujore respektivisht me 0.14 pikë përqindje, duke shkuar në 1.47 për qind. Normat e interesit të depozitave me afate të maturimit 3 dhe 6-mujore pësuan gjithashtu rënie respektivisht me 0.21 dhe 0.17 pikë përqindje, duke shkuar në nivelet e 0.83 dhe 1.16 për qind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rënie kanë pësuar normat e interesit të depozitave për të gjitha afatet e maturimit 1, 3, 6 dhe 12-mujore.

Fig-3




*Normat e interesit për depozitat (%)*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit dhjetor shënoi rënie me 1.06 pikë përqindje, duke arritur në 7.00 për qind nga 8.06 për qind që ishte në muajin nëntor 2014. Ndërsa norma e interesit të huave 6-mujore për këtë muaj shënoi një rritje me 0.11 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë. Interesi i huave 6-mujore për muajin nëntor arriti në 8.19 për qind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, normat e interesit të huave me afate maturimi 6-mujore kanë shënuar rritje, ndërsa normat e interesit të huave me afate maturimi 12–mujore kanë shënuar rënie.

Fig-4




*Normat e interesit për huatë dhe bonot (%)*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit dhjetor 2014, për bonot 12, 6 dhe 3-mujore ishin përkatësisht 3.33, 3.16 dhe 3.15 për qind. Gjatë këtij muaji, vihet re një rënie në *yield*-et e bonove të thesarit për afatet e maturimit 3, 6 dhe 12-mujore repektivisht me 0.33, 0.38 dhe 0.25 pikë përqindje krahasuar me muajin nëntor 2013.

# 4.Bilanci i Pagesave

Bilanci i pagesave për periudhën janar–shtator 2014 regjistroi nje deficit të përgjithshëm prej 89.75 milionë euro, karakteristika strukturore e të cilit paraqitet në figurën 5. Kontributin më të madh në të e jep zëri i "Llogaria korrente" së bashku me nënzërat e saj, me -901.46 milionë euro, duke u rritur në vlerë absolute me 21.2% krahasuar me 9-mujorin e parë të vitit 2014. "Llogaria kapitale dhe financiare" për 9-mujorin e parë vitit 2014 rezultoi të jetë me një deficit prej 628.2 milionë euro, ose gati 203.3% më e ulët se në 9 - mujorin e parë të vitit 2013.

Fig-5




***Bilanci i Pagesave 9M 2014***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-6




***Llogaria Korente T3 2014***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Kompozicioni i llogarisë korrente prej -901.6 milionë euro, është shprehur sipas elementeve kryesorë përbërës (në terma neto) për periudhën janar – shtator '14: *(i)* bilanci tregtar -1,489.13 mln euro, *(ii)* shërbime neto 163.70 mln euro, *(iii)* të ardhura neto -79.68 mln euro, (iv) transferta neto 503.65 mln euro. Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet në figurën 6.

# 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit dhjetor 2014, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), në rreth 45743.8 milionë lekë krahasuar me dhjetorin e vitit 2013. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 27844.0 milionë lekë dhe si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë, me rreth 17899.8 milionë lekë.

Fig-7




*Ecuria e M.V.N. të sistemit në dhjetor '13 - dhjetor '14*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-8




*Agregati M3 dhjetor'13 - dhjetor'14*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në muajin dhjetor '14 sistemi bankar rezulton me një rritje prej 5372.3 milionë lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin dhjetor '14, rritje e cila erdhi si rezultat i rritjes së nivelit të mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 1513.2 milionë lekë. Rënia nga ana tjetër e nivelit të mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë me rreth 3859.1 milionë lekë e frenoi rritjen edhe më tepër të mjeteve valutore neto të sistemit bankar.

# 6. Kredia për Ekonominë

Teprica e kredisë për ekonominë për muajin dhjetor 2014 arriti në 660.0 miliardë lekë. Rritja e tepricës së kredisë, krahasuar me fundvitin 2013 shënoi gjatë muajit dhjetor një rritje me vlerë 12.1 miliardë lekë, pra një rritje prej rreth 2.2 për qind. Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave vazhdon të mbizotërohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 58.3 për qind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 326.5 miliardë lekë. Gjatë muajit dhjetor 2014, zëri "Korporata jofinanciare private", zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 66.5 për qind ose 372.1 miliardë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin e 27.04 për qind ose 151.4 miliardë. Zërat "Korporata jofinanciare publike" dhe "Korporata të tjera financiare" arritën respektivisht 4.9 dhe 1.48 për qind apo 27.3 dhe 8.3 miliardë lekë.

Fig-9




***Rritja e stokut total të kredive***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin dhjetor '14, zëri "Korporata private jo-financiare" zuri peshën më të lartë të kredive në lekë, me rreth 55.4 për qind, ndjekur nga "Sektorë të tjerë rezidentë" me rreth 33.15 për qind dhe nga "Korporata publike jofinanciare", me 9.6 për qind. "Korporata private jofinanciare" dhe "Sektorë të tjerë rezidentë" zënë gjithashtu pjesën më të rëndësishme të kredive në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 74.3 për qind dhe rreth 22.7 për qind.

Fig-10




***Përberja e kredive dhjetor '14***

Burimi: Banka e Shqipërisë

# 7. Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin dhjetor ka shënuar një rritje krahasuar me muajin paraardhës nëntor 2014. Kjo ofertë arriti në rreth 1195.1 miliardë lekë në fund të muajit dhjetor '14 duke shënuar një rritje prej 29.2 miliardë lekë kundrejt nivelit të regjistruar në muajin nëntor '14. Rritja vjetore e këtij treguesi ishte 4 për qind, duke ruajtur kështu tendencën rritëse të shfaqur që nga mesi i dy viteve më përpara. Ndërsa krahasuar me muajin paraardhës tetor '14, oferta e parasë shënoi një rritje të lehtë prej 2.5 për qind.

Fig-11




*Raporte të parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare, kanë pësuar një rrritje prej 10.4 miliardë lekë në krahasim me muajin dhjetor 2013. Depozitat në valutë gjatë muajit dhjetor '14 janë mbështetur kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 85.6 për qind të depozitave në valutë. Ndërsa tek depozitat në lekë sektori i individëve ka zënë rreth 86.8 për qind të tyre.

Fig-12




*Raporti i Depozitave ndaj M3*

Burimi: Banka e Shqipërisë

# 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit dhjetor 2014, zëri "Sektorë të tjerë rezidentë" zuri nivelin më të lartë të depozitave të trasferueshme në lekë, me rreth 86.2 për qind, ndjekur nga "Korporata të tjera jo-financiare", me rreth 10.2 për qind dhe nga "Korporata jo-financiare publike", me 1.8 për qind. "Sektorë të tjerë rezidentë" dhe "Korporata të tjera jo-financiare" ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 85.6% për qind dhe rreth 11.8% për qind. "Sektorë të tjerë rezidentë" ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 86.8 për qind e totalit (në lekë).

Fig-13




***Rritja e stokut total të depozitave***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në përgjithësi, "Sektorë të tjerë rezidentë" përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 842.7 miliardë) të depozitave totale, prej rreth 977.4 miliardë lekë në muajin dhjetor 2014. Ata ndiqen nga "Korporata të tjera jo-financiare" (105.8 miliardë), "Korporata jo-financiare publike" (18.6 miliardë) dhe "Korporata të tjera financiare" (8.5 miliardë). "Qeveria lokale" kontribuoi me rreth 2.3 miliardë në totalin e depozitave. Gjatë muajit dhjetor 2014, krahasuar me një muaj më parë, niveli i përgjithshëm i depozitave shënoi një rënie prej 18.3 miliardë lekë, kjo si rezultat i rritjes së depozitave në lekë me rreth 10.9 miliardë lekë. Ndërsa nga ana tjetër rënia e depozitave në valutë me rreth 7.3 miliardë lekë ndikoi në uljen e këtij efekti rritës.

Fig-14




***Përberja e depozitave dhjetor '14***

Burimi: Banka e Shqipërisë

# SEKTORI FISKAL

## 1.Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën janar - dhjetor 2014 janë mbledhur rreth 366.7 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 438.8 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 341.3 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe 60.5 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat 55.8% janë financim i brendshëm.

Mbledhja e të ardhurave përbën rreth 99.7% të të ardhurave buxhetore për planin e periudhës, ndërsa shpenzimet përbëjnë rreth 96.1% të këtij plani. Shpenzimet korrente janë rreth 97.7% e planifikimit të periudhës të këtij zëri, ndërsa shpenzimet kapitale janë rreth 91.7% të tij.

Fig - 15




***Treguesit Fiskal, janar - dhjetor 2014***

Burimi: Ministria e Financave

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 253.5 miliardë lekë (ose rreth 97.3 % e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 12.4 miliardë lekë (ose rreth 97.4% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 69.9 miliardë lekë (ose rreth 110.1% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 20.7 miliardë lekë (ose rreth 91.4% e planit të periudhës).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 341.3 miliardë lekë, 71.4 miliardë lekë (20.9% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 40.1 miliardë lekë (11.7%) për interesat, 31.3 miliardë lekë (9.2%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 1.6 miliardë lekë (0.5%) për subvencione, 138.5 miliardë lekë (40.6%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 32.9 miliardë lekë (9.6%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 25.5 miliardë lekë (7.5%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 116.3 % (shpenzime personeli), 99.9% (shpenzime për interesat), 85.9% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 99.9% (subvencione), 102% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 88.4% dhe 133.2% (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishte 93.5%, ndërsa financimi i huaj është 89.6% e planifikimit të tyre vjetor.

## 2. Të Ardhurat sipas Burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar - dhjetor 2014 ishin rreth 366.7 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 335.9 miliardë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 20.7 miliardë lekë.

Tab - 2 *Të ardhurat gjatë janar - dhjetor 2014 (në mld Lekë)*

| Burimi | dhj '14 | dhj '13 | Ndryshimi në (%) |
|---|---|---|---|
| TVSH | 123.8 | 111.9 | 10.6 |
| Tatimi mbi fitimin | 21.5 | 15.1 | 42.4 |
| Taksa doganore | 5.9 | 5.8 | 1.7 |
| Taksat nacionale | 32.6 | 28.5 | 14.4 |
| Akcizat | 40.9 | 38.2 | 7.1 |
| Tatim mbi të ardhuart personale (TAP) | 28.9 | 29.6 | -2.4 |

*Burimi: Ministria e Financave, Statistika Fiskale Mujore: janar - dhjeor 2014.*

## 3.Financimi i Bilancit Fiskal

Deficiti prej 72.1 miliardë lekë, për periudhën janar - dhjetor 2014, u mbështet në vlerën 42.2 miliardë lekë nga burime të brendshme dhe rreth 29.9 miliardë nga burime të jashtme. Huamarrja e brendshme ishte mjeti kryesor i financimit të brendshëm (rreth 53% të totalit të deficitit), ndërsa për financimin e huaj ishte mbështetja buxhetore (rreth 42.2% të totalit të deficit).

Për muajin dhjetor 2014, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 37.5 miliardë lekë,
- Realizimi i shpenzimeve në masën 68.4 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin dhjetor 2014, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga tatimet, të cilat kapin shifrën e 34.5 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 41.1 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 17 miliardë lekë.

# Aneksi Statistikor

**Tab - 1**

| | Mujor (Monthly ) | | | | | | Mesatar Mujor (Monthly Average) | | | | | | Vjetor (Annual) | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Muaji | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | **2014** | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | **2014** | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | **2014** | Month |
| Janar | 0.4 | 0.9 | 0.8 | 0.7 | 1.0 | 0.8 | 0.40 | 1.00 | 0.80 | 0.71 | 1.00 | 0.80 | 2.1 | 3.6 | 3.3 | 1.6 | 2.7 | 1.7 | January |
| Shkurt | 0.7 | 1.1 | 2.3 | 1.3 | 1.1 | 1.4 | 0.55 | 1.02 | 1.55 | 1.01 | 1.05 | 1.10 | 1.9 | 4.7 | 4.5 | 0.6 | 2.5 | 1.9 | February |
| Mars | 0.6 | 0.1 | -0.1 | 0.4 | 0.2 | 0.5 | 0.57 | 0.71 | 1.00 | 0.80 | 0.77 | 0.90 | 1.6 | 4.1 | 4.3 | 1.0 | 2.4 | 2.2 | March |
| Prill | -0.1 | -0.4 | -0.6 | -0.1 | -0.1 | -0.6 | 0.40 | 0.42 | 0.60 | 0.58 | 0.55 | 0.53 | 1.9 | 3.7 | 4.1 | 1.6 | 2.3 | 1.7 | April |
| Maj | -0.8 | -1.2 | -1.1 | -0.8 | -1.0 | -1.1 | 0.16 | 0.10 | 0.26 | 0.32 | 0.24 | 0.20 | 2.1 | 3.3 | 4.2 | 1.9 | 2.1 | 1.6 | May |
| Qershor | -0.6 | -0.7 | -1.1 | -0.8 | -0.6 | -0.7 | 0.03 | -0.04 | 0.04 | 0.12 | 0.15 | 0.05 | 2.3 | 3.2 | 3.9 | 2.2 | 2.3 | 1.5 | June |
| Korrik | -0.7 | -0.5 | -0.7 | -0.2 | -0.8 | -0.6 | -0.07 | -0.10 | -0.07 | 0.08 | -0.03 | -0.04 | 2.2 | 3.4 | 3.6 | 2.7 | 1.6 | 1.8 | July |
| Gusht | 0.7 | 0.8 | 0.3 | 0.4 | -0.1 | 0.1 | 0.03 | 0.01 | -0.02 | 0.12 | -0.04 | -0.03 | 2.2 | 3.5 | 3.1 | 2.8 | 1.2 | 2.0 | August |
| Shtator | 0.8 | 0.7 | 0.4 | 0.2 | 0.8 | 0.3 | 0.11 | 0.09 | 0.02 | 0.13 | 0.06 | 0.01 | 2.0 | 3.4 | 2.8 | 2.6 | 1.7 | 1.5 | September |
| Tetor | 0.4 | 0.2 | 0.4 | 0.2 | 0.1 | 0.1 | 0.14 | 0.10 | 0.06 | 0.14 | 0.05 | 0.02 | 2.3 | 3.0 | 3.0 | 2.4 | 1.7 | 1.4 | October |
| Nëntor | 0.4 | 0.2 | 0.1 | 0.2 | -0.5 | -0.2 | 0.16 | 0.11 | 0.06 | 0.14 | 0.01 | 0.00 | 2.8 | 2.8 | 2.9 | 2.5 | 1.0 | 1.7 | November |
| **Dhjetor** | 1.6 | 2.2 | 1.0 | 0.9 | 1.7 | **0.7** | 0.28 | 0.28 | 0.14 | 0.20 | 0.15 | **0.06** | 3.7 | 3.4 | 1.7 | 2.4 | 1.9 | **0.7** | **December** |

*Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë* *Source : INSTAT,Bank of Albania*

**Tab - 2** **Kursi i këmbimit**
Exchange rate

Lekë për njësi të monedhës së huaj *(Lek per unit of foreign currency)*

| Monedha | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 Jan | Feb | Mar | Apr | May | Jun | Jul | Aug | Sep | Oct | Nov | Dec | Currency |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Mesatarja e periudhës* | | | | | | | | | | | | | | | | | | *Average of period* |
| USD | 94.98 | 103.94 | 100.90 | 108.18 | 105.67 | 103.24 | 102.75 | 101.55 | 101.35 | 101.89 | 103.09 | 103.26 | 104.58 | 108.41 | 110.01 | 111.99 | 113.64 | USD |
| EURO | 132.06 | 137.79 | 140.33 | 139.04 | 140.27 | 140.54 | 140.32 | 140.29 | 140.01 | 139.99 | 140.13 | 139.91 | 139.31 | 139.97 | 139.44 | 139.67 | 140.11 | EURO |
| *Fundi i periudhës* | | | | | | | | | | | | | | | | | | *In the end of period* |
| USD | 95.81 | 104.00 | 107.54 | 105.85 | 101.86 | 103.66 | 101.58 | 101.89 | 101.36 | 102.72 | 102.78 | 103.81 | 105.84 | 110.89 | 110.77 | 112.31 | 115.23 | USD |
| EURO | 137.96 | 138.77 | 138.93 | 139.59 | 140.20 | 140.44 | 140.14 | 140.27 | 140.08 | 139.86 | 140.26 | 139.02 | 139.44 | 139.89 | 139.27 | 140.10 | 140.14 | EURO |

*Burimi : Banka e Shqipërisë* *Source : Bank of Albania*

**Tab - 3** **Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)**
Annual Interest Rates (in ALL)

| Në përqindje | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 Jan | Feb | Mar | Apr | May | Jun | Jul | Aug | Sep | Oct | Nov | Dec | In percent |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Norma e depozitave** | | | | | | | | | | | | | | | | | | Deposits rates |
| 12-M | 6.78 | 6.07 | 5.87 | 5.38 | 4.17 | 2.39 | 2.46 | 2.16 | 2.21 | 1.94 | 1.76 | 1.90 | 1.83 | 1.59 | 1.65 | 1.57 | 1.51 | 12-M |
| 6-M | 5.74 | 5.16 | 4.87 | 4.50 | 3.40 | 1.87 | 1.87 | 1.66 | 1.80 | 1.62 | 1.33 | 1.36 | 1.37 | 1.35 | 1.31 | 1.33 | 1.16 | 6-M |
| 3-M | 5.05 | 4.42 | 4.22 | 3.83 | 2.72 | 1.31 | 1.53 | 1.12 | 1.22 | 1.07 | 0.97 | 1.06 | 1.13 | 1.04 | 1.00 | 1.04 | 0.83 | 3-M |
| 1-M | 4.56 | 4.70 | 4.39 | 3.62 | 2.79 | 2.43 | 2.51 | 2.25 | 2.21 | 2.12 | 2.06 | 2.03 | 1.97 | 1.80 | 1.77 | 1.61 | 1.47 | 1-M |
| **Norma e huasë** | | | | | | | | | | | | | | | | | | Lending rates |
| 12-M | 12.46 | 11.52 | 11.17 | 10.28 | 9.52 | 8.67 | 8.49 | 6.47 | 8.60 | 9.50 | 8.20 | 8.39 | 7.96 | 7.56 | 6.77 | 8.06 | 7.00 | 12-M |
| 6-M | 12.54 | 11.69 | 12.28 | 10.61 | 9.59 | 9.36 | 8.77 | 9.34 | 8.00 | 8.61 | 9.40 | 8.31 | 8.61 | 9.38 | 7.86 | 8.08 | 8.18 | 6-M |
| **Norma e letrave me vlerë** | | | | | | | | | | | | | | | | | | Securities rates |
| Bono thesari 1/ | | | | | | | | | | | | | | | | | | Treasury bills 1/ |
| 3-M | 6.30 | 5.29 | 5.31 | 5.03 | 3.40 | 3.36 | 3.24 | 3.14 | - | 3.05 | 3.02 | 2.95 | 3.05 | 3.08 | 3.08 | 3.11 | 3.15 | 3-M |
| 6-M | 7.52 | 6.41 | 6.23 | 5.65 | 3.54 | 3.71 | 3.52 | 3.40 | 3.32 | 3.27 | 3.14 | 3.16 | 3.14 | 3.13 | 3.13 | 3.15 | 3.16 | 6-M |
| 12-M | 9.14 | 7.09 | 6.95 | 6.37 | 3.66 | 3.82 | 3.79 | 3.66 | 3.56 | 3.40 | 3.26 | 3.23 | 3.20 | 3.20 | 3.25 | 3.29 | 3.33 | 12-M |

*Burimi : Banka e Shqipërisë* *Source : Bank of Albania*

Tab - 4

**TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2014**

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2014

*Të dhëna progresive (Progresive Data)* *në milionë Lekë (in million Lek)*

| Nr. | E M Ë R T I M I | Janar January | Shkurt February | Mars March | Prill April | Maj May | Qershor June | Korrik July | Gusht August | Shtator September | Tetor October | Nëntor November | Dhjetor December | ITEMS |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **TOTALI TË ARDHURAVE** | **27,774** | **53,273** | **83,627** | **116,129** | **144,617** | **175,206** | **206,183** | **236,397** | **266,733** | **299,313** | **329,140** | **366,696** | **TOTAL REVENUE** |
| I. | **Të ardhura nga ndihmat** | **624** | **1,658** | **2,991** | **3,507** | **4,053** | **5,345** | **6,369** | **6,909** | **7,467** | **7,832** | **8,625** | **10,161** | **Grands** |
| II. | **Të ardhura tatimore** | **24,326** | **47,226** | **75,147** | **103,650** | **129,936** | **157,502** | **185,910** | **214,732** | **243,272** | **274,148** | **301,439** | **335,868** | **Tax Revenue** |
| II.1 | **Nga Tatimet dhe Doganat** | **17,534** | **35,349** | **57,818** | **77,892** | **98,365** | **120,335** | **141,282** | **164,097** | **186,626** | **209,834** | **230,832** | **253,413** | **From tax offices and customs** |
| 1 | Tatimi mbi Vlerën e Shtuar | 9,472 | 19,155 | 30,197 | 40,594 | 50,361 | 61,177 | 70,693 | 81,599 | 91,908 | 103,425 | 113,751 | 123,730 | V.A. T |
| 2 | Tatimi mbi Fitimin | 1,007 | 2,363 | 6,332 | 7,950 | 9,477 | 11,167 | 12,587 | 13,924 | 16,109 | 17,634 | 19,289 | 21,479 | Profit Tax |
| 3 | Akcizat | 1,616 | 3,660 | 6,110 | 9,083 | 12,500 | 16,274 | 19,923 | 24,850 | 29,297 | 34,137 | 37,932 | 40,894 | Excise Tax |
| 4 | Tatimi mbi të Ardhurat Personale | 2,569 | 4,576 | 6,444 | 8,716 | 10,903 | 13,160 | 16,242 | 18,261 | 20,476 | 22,674 | 24,794 | 28,852 | Personal Income Tax |
| 5 | Taksa Nacionale dhe të tjera | 2,482 | 4,806 | 7,494 | 9,842 | 12,869 | 15,802 | 18,582 | 21,722 | 24,587 | 27,131 | 29,725 | 32,606 | National Taxes and others |
| 6 | Taksa Doganore | 388 | 789 | 1,241 | 1,707 | 2,255 | 2,755 | 3,255 | 3,741 | 4,249 | 4,833 | 5,341 | 5,852 | Customs Duties |
| II.2 | **Të ardhura nga Pushteti Vendor** | **796** | **1,340** | **2,162** | **4,462** | **5,448** | **6,235** | **7,571** | **8,600** | **9,693** | **10,900** | **11,564** | **12,447** | **Revenues from Local Gov.** |
| 1 | Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat) | 154 | 340 | 663 | 1,691 | 1,931 | 2,211 | 2,412 | 2,653 | 2,890 | 3,102 | 3,296 | 3,682 | Property Tax |
| 2 | Taksë mbi Biznesin e vogël | 304 | 329 | 350 | 379 | 612 | 685 | 1,318 | 1,449 | 1,540 | 1,576 | 1,661 | 1,709 | Small Business Tax |
| 3 | Taksa Lokale | 338 | 671 | 1,149 | 2,392 | 2,905 | 3,339 | 3,841 | 4,498 | 5,263 | 6,222 | 6,607 | 7,056 | Local Taxes |
| II.3 | **Të ardh nga fondet speciale** | **5,996** | **10,537** | **15,167** | **21,296** | **26,123** | **30,932** | **37,057** | **42,035** | **46,953** | **53,414** | **59,043** | **70,008** | **Social ins. contributions** |
| 1 | Sigurimi Shoqeror | 5,257 | 9,209 | 12,860 | 18,429 | 22,562 | 26,776 | 32,160 | 36,562 | 40,853 | 46,311 | 51,051 | 61,493 | Social Insurance |
| 2 | Sigurimi Shëndetsor | 735 | 1,319 | 2,283 | 2,831 | 3,522 | 4,105 | 4,841 | 5,410 | 5,990 | 6,919 | 7,746 | 8,199 | Health insurance |
| 3 | Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve | 4 | 9 | 24 | 36 | 39 | 51 | 56 | 63 | 110 | 184 | 246 | 316 | Revenues for property compesation |
| III. | **Të ardhura Jotatimore** | **2,824** | **4,389** | **5,489** | **8,972** | **10,628** | **12,359** | **13,904** | **14,756** | **15,994** | **17,333** | **19,076** | **20,667** | **Nontax Revenue** |
| 1 | Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë | 165 | 320 | 430 | 1,871 | 1,951 | 1,951 | 1,951 | 1,951 | 1,951 | 1,951 | 1,951 | 1,951 | Profit transfer from BOA |
| 2 | Të ardhura nga Inst.Buxhetore | 1,810 | 2,630 | 3,254 | 4,818 | 5,654 | 6,575 | 7,116 | 7,504 | 8,167 | 9,027 | 10,327 | 11,150 | Income of budgetary institutions |
| 3 | Dividenti | 498 | 498 | 498 | 498 | 504 | 765 | 1,362 | 1,380 | 1,380 | 1,380 | 1,380 | 1,387 | Divident |
| *4* | Tarifat shërbimeve | 139 | *404* | 612 | *842* | 1,363 | *1,602* | 1,805 | *2,070* | 2,393 | 2,608 | 2,856 | 3,167 | Tariffs on servises |
| 5 | Të tjera | 212 | 537 | 695 | 943 | 1,156 | 1,466 | 1,670 | 1,851 | 2,103 | 2,367 | 2,562 | 3,012 | Other/not allocated |
| | **TOTALI I SHPENZIMEVE** | **24,962** | **54,268** | **85,434** | **123,300** | **156,559** | **197,401** | **236,039** | **267,373** | **297,300** | **332,573** | **370,460** | **437,203** | **TOTAL EXPENDITURE** |
| I. | **Shpenzime Korrente** | **24,284** | **51,449** | **77,045** | **104,055** | **131,222** | **158,492** | **186,355** | **214,594** | **241,503** | **269,623** | **300,243** | **341,081** | **Current Expenditures** |
| I.1 | **Personeli** | **5,645** | **11,394** | **17,268** | **23,179** | **29,083** | **34,938** | **40,905** | **46,932** | **52,701** | **58,567** | **64,599** | **71,373** | **Personnel expenditures** |
| 1 | Paga | 4,856 | 9,811 | 14,866 | 19,960 | 25,033 | 30,070 | 35,215 | 40,414 | 45,381 | 50,431 | 55,614 | 61,422 | Wages |
| 2 | Kontributi për Sigurime Shoqerore | 789 | 1,583 | 2,402 | 3,219 | 4,050 | 4,868 | 5,690 | 6,518 | 7,320 | 8,136 | 8,985 | 9,951 | Social insurance contributions |
| I.2 | **Interesat** | **3,819** | **7,843** | **10,675** | **13,330** | **17,255** | **20,627** | **23,399** | **26,546** | **28,748** | **31,367** | **37,025** | **40,075** | **Interest** |
| 1 | Të Brendshme | 3,476 | 7,058 | 9,502 | 11,556 | 15,144 | 18,075 | 20,521 | 23,225 | 25,059 | 27,047 | 29,234 | 31,834 | Domestic |
| 2 | Të Huaja | 343 | 785 | 1,173 | 1,774 | 2,111 | 2,552 | 2,878 | 3,321 | 3,689 | 4,320 | 7,791 | 8,241 | Foreign |
| I.3 | **Shpenzime Operative Mirëmbajtje** | **1,275** | **3,225** | **5,394** | **8,466** | **9,670** | **11,418** | **14,588** | **17,858** | **23,082** | **26,080** | **29,396** | **33,134** | **Operational & Maintenance** |
| I.4 | **Subvecionet** | **58** | **112** | **265** | **310** | **422** | **579** | **700** | **824** | **945** | **1,187** | **1,392** | **1,599** | **Subsidies** |
| I.6 | **Shpenzime për fonde speciale** | **9,440** | **20,875** | **31,372** | **42,503** | **54,379** | **66,726** | **77,929** | **89,760** | **98,871** | **110,194** | **121,016** | **136,413** | **Social insurance outlays** |
| 1 | Sigurime Shoqerore | 7,432 | 15,127 | 23,165 | 31,405 | 39,633 | 48,179 | 56,742 | 65,923 | 74,813 | 83,269 | 91,272 | 102,794 | Social insurance |
| 2 | Sigurime Shëndetsore | 2,008 | 4,754 | 7,213 | 10,104 | 13,752 | 17,253 | 19,893 | 22,543 | 22,764 | 25,624 | 28,443 | 32,302 | Health insurance |
| 3 | Fondi I kompensimit te pronareve | 0 | 994 | 994 | 994 | 994 | 1,294 | 1,294 | 1,294 | 1,294 | 1,301 | 1,301 | 1,317 | Expenditures for Owners Compensation |
| I.7 | **Shpenzime per Buxhetin Vendor** | **1,214** | **3,118** | **5,233** | **7,583** | **9,927** | **12,121** | **14,837** | **17,123** | **19,917** | **23,240** | **26,367** | **32,967** | **Local budget expenditure** |
| I.8 | **Shpenzime të tjera** | **2,833** | **4,882** | **6,838** | **8,684** | **10,486** | **12,083** | **13,997** | **15,551** | **17,239** | **18,988** | **20,448** | **25,520** | **Other expenditures** |
| 1 | Pagesa e Papunesisë | 112 | 198 | 294 | 387 | 454 | 522 | 591 | 652 | 715 | 779 | 844 | 912 | Unemployment insurance benefits |
| 2 | Ndihma Ekonomike | 2,721 | 4,684 | 6,544 | 8,282 | 9,970 | 11,427 | 13,167 | 14,632 | 16,233 | 17,908 | 19,287 | 22,849 | Social assistance |
| 5 | Kompensimi i ish-të përndjekurve politike | 0 | | 0 | 15 | 62 | 134 | 239 | 267 | 291 | 301 | 317 | 1,759 | Compansation for ex-political prisioners |
| III | **Shpenzime Kapitale** | **678** | **2,819** | **7,357** | **11,493** | **13,962** | **19,817** | **23,935** | **26,906** | **29,887** | **36,613** | **43,504** | **60,611** | **Capital expenditures** |
| 1 | Financimi Brendshëm | 0 | 642 | 1,310 | 4,052 | 4,616 | 7,109 | 8,893 | 10,225 | 11,560 | 15,760 | 20,662 | 33,964 | Domestically financing |
| 2 | Financimi Huaj | 678 | 2,177 | 6,047 | 7,441 | 9,346 | 12,708 | 15,042 | 16,681 | 18,327 | 20,853 | 22,842 | 26,647 | Foreign financed |
| IV. | **Detyrimet e prapambetura** | 0 | | **1,032** | **7,752** | **11,375** | **19,092** | **25,749** | **25,873** | **25,910** | **26,168** | **26,544** | **33,842** | |
| 1 | Detyrimet e infrastruktures | 0 | | 0 | 1,616 | **3,489** | 5,963 | **8,440** | 8,440 | 8,442 | 8,442 | 8,751 | 9,838 | |
| 2 | Detyrimet tatimore | 0 | | **1,032** | 6,136 | **6,758** | 9,010 | **12,575** | 12,699 | 12,730 | 12,761 | 12,764 | 12,838 | |
| 3 | Te tjera | 0 | | 0 | | **1,128** | 4,119 | **4,734** | 4,734 | 2,451 | 2,678 | 2,740 | 7,737 | |
| | **DEFICITI** | **2,812** | **-995** | **-1,807** | **-7,171** | **-11,942** | **-22,195** | **-29,856** | **-30,976** | **-30,567** | **-33,260** | **-41,320** | **-70,507** | **CASH BALANCE** |
| | **FINANCIMI DEFICITIT** | **-2,812** | **995** | **1,807** | **7,171** | **11,942** | **22,195** | **29,856** | **30,976** | **30,567** | **33,260** | **41,320** | **70,507** | **CASH BALANCE FINANCING** |
| | **Brendshëm** | **-2,180** | **1,744** | **441** | **6,554** | **10,464** | **16,474** | **23,306** | **1,865** | **1,356** | **4,037** | **12,117** | **40,747** | **Domestic** |
| | Të ardhura nga privatizimi | 0 | 1 | 1 | 2 | 4 | 10 | 11 | 19 | 26 | 29 | 30 | 35 | Privatization receipts |
| | Hua-marrje e brendshme | 3,473 | 4,696 | 8,647 | 11,026 | 15,576 | 21,436 | 26,539 | 31,351 | 33,205 | 35,273 | 33,014 | 38,212 | Domestic new borrowing (net) |
| | Nacionale | 3,482 | 4,707 | 8,660 | 11,048 | 15,600 | 21,419 | 26,336 | 31,126 | 32,953 | 34,971 | 32,682 | 37,750 | Other |
| | Lokale | -9 | -11 | -13 | -22 | -24 | 17 | 203 | 225 | 252 | 302 | 332 | 462 | Foreign |
| | Të tjera | -5,652 | -2,953 | -8,207 | -4,474 | -5,116 | -4,972 | -3,244 | -29,505 | -31,875 | -31,265 | -20,927 | 2,500 | Other |
| | Depozitë e Qeverisë në Bankën e Shqipërisë | 1,838 | 4,269 | 771 | 2,125 | 3,815 | 3,145 | 2,434 | -22,414 | -25,896 | -25,770 | -14,083 | 5,494 | Government deposits into the Central Bank |
| | Të tjera | -7,489 | -7,222 | -8,978 | -6,597 | -8,931 | -8,115 | -5,679 | -7,094 | -5,981 | -5,495 | -6,846 | -2,993 | Other |
| | Depozita e ISSH dhe ISKSH | -3,545 | -3,102 | -3,585 | -3,093 | -4,137 | -4,309 | -4,426 | -3,708 | -3,338 | -2,935 | -3,492 | -5,883 | Deposits of Socila and Health insurance |
| | Mjete në ruajtje | 22 | 75 | 99 | 118 | 234 | 316 | 523 | 614 | 612 | 571 | 1,444 | 2,729 | Preservation stock |
| | Nënhua | 314 | 369 | 552 | 916 | 1,029 | 1,049 | 1,105 | 1,109 | 1,355 | 1,486 | 1,547 | 1,581 | On-Loan Principal |
| | Detyrim ndaj ISSH | -220 | -99 | -303 | 712 | 79 | -5 | 70 | -15 | 31 | 92 | 161 | 714 | Liabilities to SSI |
| | Të tjera (detyrime të përkohshme) | 653 | 522 | 535 | -762 | 36 | 31 | 70 | 168 | 157 | 141 | 126 | 168 | Other-Float |
| | **I huaj** | **-632** | **-749** | **1,366** | **617** | **1,478** | **5,721** | **6,550** | **29,111** | **29,211** | **29,223** | **29,203** | **29,760** | **Foreign** |
| | Hua afatgjatë(e marrë) | 198 | 534 | 3,153 | 3,996 | 5,284 | 8,390 | 9,986 | 10,952 | 12,070 | 13,931 | 15,713 | 18,996 | Long-term foreign borrowing (gross) |
| | Nga e cila nënhua | 0 | | 1,665 | 1,642 | 1,670 | 2,109 | 2,145 | 2,157 | 2,771 | 2,819 | 2,780 | 3,106 | |
| | Ndryshimi i gjendjes së arkes* | -142 | -44 | 51 | 185 | 241 | -808 | -747 | -611 | -637 | -335 | -903 | -1,851 | Chang. of stat. Account |
| | Ripagesat | -688 | -1,385 | -1,984 | -7,399 | -8,573 | -10,125 | -10,953 | -11,690 | -12,682 | -14,833 | -16,067 | -17,845 | Repayments |
| | Mbështetje Buxhetore | 0 | 146 | 146 | 3835 | 4526 | 8264 | 8264 | 30460 | 30,460 | 30460 | 30,460 | 30460 | Budgetary Support |

*Burimi : Ministria e Financave* *Source : Ministry of Finance*

Tab - 5

**Tabela e investimeve 2014**
Table of investments 2014

*Të dhëna progresive (Progresive Data)* *në milionë Lekë ( in million Lek)*

| | Janar January | Shkurt Feb | Mars Mar | Prill Apr | Maj May | Qershor Jun | Korrik Jul | Gusht Aug | Shtator Sep | Tetor Oct | Nentor Nov | Dhjetor Dec | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Financim i brendshëm** | **0** | **642** | **1,310** | **4,052** | **4,616** | **7,109** | **8,893** | **10,225** | **11,560** | **15,760** | **20,662** | **33,964** | **Domestic financing** |
| *Në %* | *0.00* | *22.77* | *17.81* | *35.26* | *33.06* | *35.87* | *37.15* | *38.00* | *38.68* | *43.04* | *47.49* | *56.04* | *In %* |
| **Financim i huaj** | **678** | **2,177** | **6,047** | **7,441** | **9,346** | **12,708** | **15,042** | **16,681** | **18,327** | **20,853** | **22,842** | **26,647** | **Foreign financing** |
| *Në %* | *100.00* | *77.23* | *82.19* | *64.74* | *66.94* | *64.13* | *62.85* | *62.00* | *61.32* | *56.96* | *52.51* | *43.96* | *In %* |
| **Totali** | **678** | **2,819** | **7,357** | **11,493** | **13,962** | **19,817** | **23,935** | **26,906** | **29,887** | **36,613** | **43,504** | **60,611** | **Total** |
| *Në %* | *100* | *100* | *100* | *100* | *100* | *100* | *100* | *100* | *100* | *100* | *100* | *100* | *In %* |

Burimi: Ministria e Financave Source: Ministry of Finance

Tab - 6

**TË ARDHURAT DOGANORE 2014 (CUSTOMS REVENUES 2014)**

*Të dhëna progresive (Progresive Data)* *në milionë Lekë ( in million Lek)*

| | Janar January | Shkurt Feb | Mars Mar | Prill April | Maj May | Qershor June | Korrik July | Gusht Agust | Shtator September | Tetor Oct | Nentor Nov | Dhjetor Dec | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Taksë doganore | 388 | 789 | 1,241 | 1,707 | 2,255 | 2,755 | 3,255 | 3,741 | 4,249 | 4,833 | 5,341 | 5,852 | Customs Duties |
| TVSH | 6,594 | 13,683 | 21,998 | 29,944 | 38,183 | 46,543 | 54,528 | 63,228 | 71,477 | 80,481 | 88,499 | 97,391 | V.A.T |
| Akcizë | 1,616 | 3,660 | 6,109 | 9,083 | 12,499 | 16,273 | 19,922 | 24,849 | 29,295 | 34,131 | 37,927 | 40,887 | Excises |
| Të tjera | 704 | 1,268 | 1,824 | 2,582 | 3,450 | 4,041 | 4,473 | 5,124 | 5,377 | 5,815 | 6,377 | 6,559 | Others |
| **TOTALI** | **9,302** | **19,400** | **31,172** | **43,316** | **56,387** | **69,612** | **82,178** | **96,942** | **110,398** | **125,260** | **138,144** | **150,689** | **Total** |

**TË ARDHURAT TATIMORE 2014 (TAX REVENUE )**

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| TVSH | 2,879 | 5,472 | 8,199 | 10,647 | 12,177 | 14,634 | 16,166 | 18,370 | 20,448 | 22,962 | 25,252 | 26,339 | V.A.T |
| Akciza | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 6 | 6 | 7 | Excises |
| Tatim mbi fitimin | 1,007 | 2,363 | 6,332 | 7,950 | 9,477 | 11,167 | 12,587 | 13,924 | 16,109 | 17,634 | 19,289 | 21,479 | Profit Tax |
| Tatimi mbi të ardhurat personale | 2,568 | 4,575 | 6,444 | 8,716 | 10,902 | 13,160 | 16,242 | 18,260 | 20,476 | 22,674 | 24,794 | 28,852 | Personal income tax |
| Taksa nacionale dhe të tjera | 1,778 | 3,538 | 5,670 | 7,260 | 9,419 | 11,761 | 14,109 | 16,598 | 19,210 | 21,316 | 23,348 | 26,047 | National taxes |
